


Bizneset e Huaja në Shqipëri 2016-2018

INSTAT



Dhjetor, 2019

Parathënie dhe Mirënjohje

Instituti i Statistikave të Shqipërisë (INSTAT), në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, hartoi një publikim të veçantë për treguesit kryesorë të ndërmarrjeve me pronësi të huaj dhe të përbashkëta që operojnë në Shqipëri. Duke iu referuar periudhës nga viti 2016-2018, statistikatat në lidhje me ndërmarrjet private të huaja dhe të përbashkëta (shqiptare dhe të huaja) synojnë të monitorojnë situatën, strukturën, intensitetin e tregtisë dhe performancën e tyre brenda territorit të Shqipërisë.

Në strategjinë e re të komunikimit, INSTAT është orientuar që të përmbushë nevojat e përdoruesve duke targetuar grupe të ndryshme përdoruesish. Ky publikim pasqyron disa nga kërkesat themelore dhe nevojat e disa grupeve të përdoruesve, për të dhënat mbi ndërmarrjet e huaja dhe aktivitetin e tyre ekonomik në Shqipëri.

Ky publikim i dedikuar, paraqet me anë të shifrave realitetin ekonomik në vend si dhe përgjigjet ndaj kërkesave në rritje për informacion statistikor të vendimarrësve, kërkuesve shkencor dhe akademikëve në Shqipëri.

Ky publikim do të ishte i pamundur pa bashkëpunimin e ndërmarrjeve për t'ju përgjigjur pyetësorëve të organizuar nga INSTAT dhe të dhënave administrative të siguruar nga institucionet e tjera. Kontributi i Bankës së Shqipërisë për të dhënat e Investimeve të Huaja Direkte (IHD), është një vlerë e shtuar në këtë publikim.

Bashkëpunimi me institucionet e tjera dhe politikë-bërësit, rrit përgjegjësinë e INSTAT për hartimin e publikimeve të veçanta dhe informacioneve statistikore që do të shërbenin për të kuptuar më mirë realitetin ekonomik, në mënyrë që të ballafaqohemi me sfidat e së ardhmes.

INSTAT, gjithmonë do ofrojë partneritet të vazhdueshëm dhe një bashkëpunim të frytshëm, ashtu siç e dëshmon dhe ky botim.

Elsa Dhuli, PhD

Drejtor i Përgjithshëm i Komanduar i INSTAT

Përmbajtja

Hyrje	5
A. Ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta	6
Tabela 1: Ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta.....	6
Fig.1 Struktura e ndërmarrje të huaja e të përbashkëta sipas rajoneve, 2018 (%)	6
Fig.2: Ndërmarrje të huaja dhe të përbashkëta sipas shteteve (%)	7
Tab. 2 Ndërmarrje të huaja dhe të përbashkëta sipas shteteve.....	7
Tab. 3 Ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta sipas pronësisë dhe rajoneve.....	8
Tab. 4 Ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta sipas aktivitetit ekonomik dhe rajoneve	8
Tab. 5 Ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta sipas madhësisë së ndërmarrjes	9
B. Treguesit kryesorë ekonomikë të ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta	10
Fig.3: Përqindja e treguesve kryesorë në ndërmarrjet me pronësi të huaj dhe të përbashkët ndaj ndërmarrjeve shqiptare, 2016-2018.....	10
Tab. 6: Struktura e treguesve kryesorë në ndërmarrjet me pronësi të huaj dhe të përbashkët sipas shteteve, 2016-2018	11
Fig. 4: Struktura e punësimit në ndërmarrjet me pronësi të huaj dhe të përbashkët	12
Fig.5: Struktura e shitjeve neto në ndërmarrjet me pronësi të huaj dhe të përbashkët.....	12
Tab. 7: Struktura e treguesve kryesorë sipas aktivitet ekonomik, 2016-2018	13
Fig.6: Struktura e punësimit sipas rajoneve për çdo aktivitet ekonomik, 2018	13
Fig.7: Struktura e shitjeve neto sipas rajoneve për çdo aktivitet ekonomik, 2018.....	14
Fig.8: Struktura e investimeve sipas rajoneve për çdo aktivitet ekonomik, 2018	15
Tab. 8: Struktura e shitjeve për ndërmarrjet me pronësi të huaj dhe të përbashkët sipas shteteve për çdo aktivitet ekonomik, 2018	16
Fig.9: Përqindja e treguesve kryesorë sipas madhësisë së ndërmarrjes, 2018	17
C. Investimet e Huaja Direkte (IHD)	17
Tab. 9: IHD, Stoku sipas vendeve (mil Euro)	17
Tab. 10: IHD, Fluksi sipas vendeve (mil Euro)	18
Tab.11: IHD, Stoku sipas aktiviteteve (mil Euro).....	18
Tab. 12: IHD, Fluksi sipas aktiviteteve (mil Euro)	19
D. Tregtia e Mallrave sipas Ndërmarrjeve.....	19
Tab. 13 Numri i ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta sipas vendeve, 2016-2018	20
Tab.14 Eksportet dhe importet e ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta në totalin e ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta, sipas vendeve, 2016-2018	21

Tab. 15 Struktura eksport / import e ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta në totalin e ndërmarrjeve, 2016-2018	22
Tab. 16 Struktura eksport / import e ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta nga BE në totalin e ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta, 2016-2018.....	22

Hyrje

Ky material i përgatitur nga INSTAT në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, përfshin të dhëna për vitet referencë 2016-2018 dhe do të jetë publikim i vazhdueshëm me frekuencë vjetore.

Materiali përbëhet nga katër kapituj. Kapitulli i parë paraqet numrin e ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta që operojnë në Shqipëri, të ndara sipas llojit të pronësisë, vendit të investitorit, aktivitetit kryesor ekonomik dhe madhësisë.

Kapitulli i dytë shpreh rolin dhe ndikimin e ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta në treguesit e punësimit, shitjeve neto dhe investimeve.

Kapitulli i tretë paraqet lëvizjen e Investimeve të Huaja Direkte (IHD), Flow dhe Stock, sipas vendeve dhe veprimtarive që i referohen të dhënave nga Banka e Shqipërisë.

Kapitulli i katërt fokusohet në strukturën e ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta, eksportet dhe importet në ekonominë e Shqipërisë.

Duke iu referuar periudhës 2016-2018, statistikat në lidhje me ndërmarrjet private të huaja dhe të përbashkëta synojnë të monitorojnë situatën, strukturën, intensitetin e tregtisë dhe performancën e tyre brenda territorit shqiptar.

Gjetjet kryesore të shkruara në material tregojnë që në vitin 2018, ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta kanë punësuar 15,6 % të punësimit gjithsej dhe kanë kontribuar me 25,8 % në xhiron vjetore gjithsej.

Ndërmarrjet me pronësi 100 % të huaj përfaqësojnë 65,6 % të ndërmarrjeve të huaja e të përbashkëta gjithsej, ndërsa ndërmarrjet e përbashkëta me mbizotërim të huaj përfaqësojnë 13,7 % të totalit.

Në fund të vitit 2018, numri i ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta u ul me 0,6 %, krahasuar me vitin 2017. Për vitin 2018, peshën më të mëdha të ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta e japin Italia dhe Greqia me 52,8 % të ndërmarrjeve; 60,6 % të punësimit; 52,3 % të eksporteve dhe 53,2 % të importeve.

A. Ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta

Në vitin 2018, ndërmarrjet e huaja e të përbashkëta që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë janë 6.259, ndërsa në fund të vitit 2017 ishin 6.295 ndërmarrje.

Tabela 1: Ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta


Pronësia	2016		2017		2018	
	numër	%	numër	%	numër	%
Gjithsej	160.679	100	162.452	100	162.835	100
Shqiptare 100%	155.042	96,5	156.157	96,1	156.576	96,2
Të huaja e të përbashkëta	5.637	3,5	6.295	3,9	6.259	3,8
<i>nga të cilat</i>						
Të huaja 100%	4.024	2,5	3.704	2,3	4.109	2,5
Të përbashkëta	1.613	1,0	2.591	1,6	2.150	1,3
<i>nga të cilat</i>						
Mbizotërim Shqiptar	822	0,5	1.476	0,9	1.294	0,8
Mbizotërim i huaj	791	0,5	1.115	0,7	856	0,5

Burimi: INSTAT

Në vitin 2018 ndërmarrjet me origjinën nga shtetet e Bashkimit Evropian zënë 2,5 % të ndërmarrjeve aktive gjithsej në Shqipëri, dhe 64,8 % të ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta.


Ndërmarrjet me origjinë nga shtetet e Ballkanit Perëndimor përfaqësojnë 10,3 % dhe ndërmarrjet me origjinë nga shtetet e tjera zënë 24,9 % të ndërmarrjeve të huaja e të përbashkëta.

Fig.1 Struktura e ndërmarrje të huaja e të përbashkëta sipas rajoneve, 2018 (%)



Ndërmarrjet e mëdha të huaja e të përbashkëta janë të përqëndruara kryesisht në aktivitetet ekonomike si call center, prodhimi i këpucëve dhe aktiviteti bankar. Ndërmarrjet e huaja e të përbashkëta me pronarë nga Greqia dhe Italia përfaqësojnë 52,8 % të ndërmarrje gjithsej.

Fig.2: Ndërmarrje të huaja dhe të përbashkëta sipas shteteve (%)



Tab. 2 Ndërmarrje të huaja dhe të përbashkëta sipas shteteve

Ndërmarrjet e huaja e të përbashkëta		2016		2017		2018		2019	
		Gjithsej	Të huaja 100%	Të huaja e të përbashkëta	Gjithsej	Të huaja 100%	Të huaja e të përbashkëta	Gjithsej	Të huaja e të përbashkëta
TOTAL		5.637	4.024	1.613	6.295	3.704	2.591	6.259	4.109
Shtetet e BE	Austria	107	71	36	76	47	29	57	32
	Britania e Madhe	86	61	25	98	51	47	89	55
	Gjermania	155	101	54	180	121	59	172	124
	Greqia	522	314	208	510	250	260	453	249
	Hollanda	40	24	16	49	32	17	51	34
	Italia	2.662	1.850	812	2.887	1.619	1.268	2.853	1.821
	Spanja	38	26	12	25	14	11	24	15
	Të tjera BE	334	241	93	372	228	144	357	235
	Gjithsej shtetet e BE-së	3.944	2.688	1.256	4.197	2.362	1.835	4.056	2.565
Shtetet e Ballkanit Perëndimor	Bosnja&Hercegovina	8	8	0	14	11	3	11	8
	Kosova	446	347	99	478	319	159	423	290
	Mali Zi	14	10	4	26	18	8	23	17
	Maqedonia e Veriut	100	82	18	170	123	47	146	103
	Serbia	46	37	9	56	33	23	42	26
	Gjithsej shtetet e	614	484	130	744	504	240	645	444
	Gjithsej shtetet e	614	484	130	744	504	240	645	444
Shtetet e tjera	Emiratet e Bashkuara	20	13	7	12	7	5	36	19
	Kanada	18	15	3	32	19	13	27	21
	Kina	72	58	14	81	59	22	77	59
	Sh. B. A	133	89	44	126	72	54	113	72
	Turqia	434	355	79	433	273	160	374	242
	Zvicra	44	35	9	58	40	18	48	37
	Të tjera	358	287	71	612	368	244	883	650
	Gjithsej shtete të tjera	1.079	852	227	1.354	838	516	1.558	1.100

Burimi: INSTAT

Ndërmarrjet me pronësi 100 % të huaj përfaqësojnë 65,6 % të totalit të ndërmarrjeve të huaja e të përbashkëta, ndërsa ndërmarrjet e përbashkëta me mbizotërim të huajt përfaqësojnë 13,7 % të totalit.

Tab. 3 Ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta sipas pronësisë dhe rajoneve

Pronësia	2016				2017				2018			
	Gjithsej	Shtetet e BE-së	Shtetet e Ballkanit Perëndimor	Shtetet e tjera	Gjithsej	Shtetet e BE-së	Shtetet e Ballkanit Perëndimor	Shtetet e tjera	Gjithsej	Shtetet e BE-së	Shtetet e Ballkanit Perëndimor	Shtetet e tjera
Gjithsej	5.637	3.944	614	1.079	6.295	4.197	744	1.354	6.259	4.056	645	1.558
Të huaja 100%	4.024	2.688	484	852	3.704	2.362	504	838	4.109	2.565	444	1.100
Të përbashkëta	1.613	1.256	130	227	2.591	1.835	240	516	2.150	1.491	201	458
Mbizotërim Shqiptar	822	621	82	119	1.476	975	157	344	1.294	856	129	309
Mbizotërim i Huaj	791	635	48	108	1.115	860	83	172	856	635	72	149

Burimi: INSTAT

Në ekonominë shqiptare, ndërmarrjet nga Shtetet EU janë mbizotëruese në shërbime të tjera (25,1 %), tregti (15,8 %) dhe industri (10,9 %) ndaj totalit të ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta.

Tab. 4 Ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta sipas aktiviteti ekonomik dhe rajoneve

Aktiviteti ekonomik		Gjithsej	Prodhuesit e të mirave	Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	Industria	Ndërtimi	Prodhuesit e shërbimeve	Tregtia	Transporti dhe magazinimi	Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	Informacioni dhe komunikacioni	Shërbime të tjera
2016	Gjithsej	5.637	1.523	61	1.009	453	4.114	1.621	117	239	279	1.858
	Shtetet e BE-së	3.944	1.140	44	765	331	2.804	1.046	80	116	195	1.367
	Shtetet e Ballkanit Perëndimor	614	141	9	92	40	473	233	14	64	34	128
	Shtetet e tjera	1.079	242	8	152	82	837	342	23	59	50	363
2017	Gjithsej	6.295	1.645	71	1.096	478	4.650	1.721	121	337	339	2.132
	Shtetet e BE-së	4.197	1.201	50	804	347	2.996	1.038	87	126	231	1.514
	Shtetet e Ballkanit Perëndimor	744	174	7	123	44	570	262	14	132	31	131
	Shtetet e tjera	1.354	270	14	169	87	1.084	421	20	79	77	487
2018	Gjithsej	6.259	1.477	73	942	462	4.782	1.721	115	304	373	2.269
	Shtetet e BE-së	4.056	1.055	50	681	324	3.001	991	75	114	252	1.569
	Shtetet e Ballkanit Perëndimor	645	143	6	90	47	502	245	18	94	29	116
	Shtetet e tjera	1.558	279	17	171	91	1.279	485	22	96	92	584

Burimi: INSTAT

Në vitin 2018, ndërmarrjet e vogla nga vendet e BE-së mbulonin 77,8 % të të gjitha ndërmarrjeve të BE-së, ndërsa kompanitë e mëdha mbulonin 1,1 %.

Kjo përqindje e bizneseve të vogla dhe të mëdha lidhet me veprimtarinë ekonomike ku ata veprojnë.

Tab. 5 Ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta sipas madhësisë së ndërmarrjes

Madhësia sipas të punësuarve	Gjithsej	2016			Gjithsej	2017			Gjithsej	2018		
		Shtetet e BE-së	Shtetet e Ballkanit Perëndimor	Shtetet e tjera		Shtetet e BE-së	Shtetet e Ballkanit Perëndimor	Shtetet e tjera		Shtetet e BE-së	Shtetet e Ballkanit Perëndimor	Shtetet e tjera
Gjithsej	5,637	3,944	614	1,079	6,295	4,197	744	1,354	6,259	4,056	645	1,558
01-04	4,359	3,042	507	810	4,792	3,174	578	1040	4,972	3,157	549	1266
05-09	466	300	54	112	566	355	97	114	527	335	61	131
10-49	505	363	42	100	608	407	60	141	504	363	30	111
50-249	233	187	c	37	256	213	6	37	198	156	5	37
250+	74	52	c	c	73	48	3	22	58	45		13

Burimi: INSTAT


B. Treguesit kryesorë ekonomikë të ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta¹

Statistikat mbi ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta synojnë të monitorojnë rëndësinë, strukturën dhe performancën e këtyre ndërmarrjeve brenda territorit shqiptar.

Çfarë ndikimi?

Në vitin 2018, ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta kanë punësuar 15,6 % të punësimit gjithsej nga 18,7 % në vitin 2017. Shitjet neto të realizuara nga ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta përbëjnë 25,8 % të shitjeve neto të ndërmarrjeve gjithsej në vitin 2018, ndërsa gjatë vitit të kaluar ky tregues ishte 30,3 %. Përqindja e investimeve të realizuara nga ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta është 25,0 % e investimeve gjithsej të vitit 2018, ndërsa në vitin 2017 ishte 30,4 %.

Fig.3: Përqindja e treguesve kryesorë në ndërmarrjet me pronësi të huaj dhe të përbashkët ndaj ndërmarrjeve shqiptare, 2016-2018



Burimi: INSTAT

Nga cilat vende?

Në vendet e BE-së, gjatë vitit 2018, Italia (50,4 % e punësimit dhe 27,3 % e shitjeve neto) dhe Greqia (10,2 % e punësimit dhe 10,3 % e shitjeve neto) janë dy shtetet me pjesën më të madhe të punësimit dhe shitjeve neto. Turqia mbulon 8,2 % të punësimit dhe 10,9 % të shitjeve neto dhe ka ndikimin më të madh në grupin e vendeve të tjera. Në vendet e Ballkanit Perëndimor, Kosova mbulon 2,8 % të punësimit dhe 4,5 % të shitjeve neto.

¹ Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve përfshin të gjitha format legale të ndërmarrjeve aktive që prodhojnë të mira e shërbime për treg por përjashton nga studimi aktivitetet e bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit, aktivitetet financiare dhe të sigurimit, administrimi publik dhe i mbrojtjes; sigurimi social i detyrueshëm si edhe aktivitetet e organizatave ndërkombëtare.

Ndërmarrjet me pronësi nga vendet e BE-së investuan 45,5 % të totalit të investimeve të kryera nga ndërmarrjet e huaja në vitin 2018. Pjesa më e madhe është investuar nga Italia (14,0 %). Për grupin e vendeve të tjera, Republika Popullore e Kinës (17,4 %) dhe Turqia (10,4 %) dominojnë në vlerën e investimeve të bëra gjatë vitit 2018, ndërsa për vendet e Ballkanit Perëndimor është Kosova (3,6 %).


Tab. 6: Struktura e treguesve kryesorë në ndërmarrjet me pronësi të huaj dhe të përbashkët sipas shteteve, 2016-2018

		%								
Ndërmarrjet me pronësi të huaj dhe të përbashkët		Të punësuarit			Shitjet			Investimet		
		2016	2017	2018	2016	2017	2018	2016	2017	2018
Shtetet e BE-së	Austria	3,1	2,1	0,9	5,5	3,1	1,2	14,8	17,8	0,0
	Britania e madhe	0,3	0,5	0,5	0,2	0,2	1,0	0,1	0,0	0,0
	Gjermania	4,0	3,7	4,0	6,8	4,9	6,1	2,7	3,0	10,1
	Hollanda	0,8	0,6	3,3	1,8	1,6	2,3	0,1	0,1	3,0
	Greqia	10,9	9,9	10,2	13,2	11,3	10,3	3,6	10,5	13,6
	Italia	49,6	49,0	50,4	25,2	24,1	27,3	9,9	16,1	14,0
	Shtete të tjera të BE-së	5,8	4,5	7,6	8,2	16,9	15,2	0,8	2,0	4,8
	Gjithsej Shtetet e BE-së	74,6	70,2	76,8	60,9	62,1	63,4	32,0	49,5	45,5
Shtetet e Ballkanit Perëndimor	Bosnja & Hercegovina	0,1	0,0	0,0	0,2	0,0	0,0	0,6	0,0	0,0
	Serbia	0,5	0,7	0,5	2,1	2,9	1,0	0,1	1,3	0,3
	Kosova	2,9	5,2	2,8	2,9	3,0	4,5	1,5	1,9	3,6
	Mali i Zi	0,2	0,0	0,1	0,5	0,3	0,1	0,0	0,0	0,0
	Maqedonia e Veriut	0,5	1,3	0,9	1,5	1,9	1,9	0,4	0,3	0,3
	Shtetet e Ballkanit Perëndimor	4,1	7,2	4,2	7,3	8,1	7,5	2,6	3,6	4,2
Shtete të tjera	Emiratet e Bashkuara Arabe	0,3	0,3	1,4	0,4	0,3	1,1	0,2	0,1	0,2
	Kanada	1,4	1,1	0,5	6,6	3,8	0,5	1,5	11,2	0,0
	Republika Popullore e Kinës	0,8	1,0	1,6	1,3	0,8	6,1	0,3	0,5	17,4
	Sh B A	1,2	0,9	0,4	0,8	0,5	1,0	0,2	0,8	0,4
	Turqi	10,4	10,5	8,2	12,5	11,5	10,9	20,2	32,6	10,4
	Zvicër	1,0	0,9	1,9	3,5	2,4	2,7	42,4	0,2	2,4
	Shtete të tjera	6,1	7,9	5,1	6,8	10,5	6,8	0,5	1,5	19,5
	Shtete të tjera gjithsej	21,3	22,6	18,9	31,9	29,8	29,0	65,4	46,9	50,4

Burimi: INSTAT

Vendet e BE-së kanë pjesën më të madhe të punësimit në ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta; në vitin 2018 këto vende zënë 76,8 % të punësimit, ndërsa në vitin 2017 ky tregues ishte 70,2 %.


Fig. 4: Struktura e punësimit në ndërmarrjet me pronësi të huaj dhe të përbashkët



Burimi: INSTAT

Përsa i përket shitjeve neto, situata duket e ngjashme me atë të punësimit. Vendet e BE-së kanë pjesën më të madhe të shitjeve neto në ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta me 63,4 % gjatë vitit 2018, nga 62,1 % në vitin 2017.

Fig.5: Struktura e shitjeve neto në ndërmarrjet me pronësi të huaj dhe të përbashkët



Burimi: INSTAT

Cilët sektorë?

Gjatë vitit 2018, për treguesin e punësimit, përqindja më e lartë e ndërmarrjeve me pronësi të huaj dhe të përbashkët është në sektorin e Industrisë përpunuese me 41,7 %, e cila tregon një rritje prej 8,5 p.p. krahasuar me vitin 2017.

Përsa i përket shitjeve neto, gjatë vitit 2018, pjesa më e madhe e ndërmarrjeve me pronësi të huaj dhe të përbashkët është në sektorin e Tregtisë (24,5 %) duke u ulur me 16,8 p.p., krahasuar me 2017 dhe në sektorin e Shërbimeve të tjera (19,5 %) duke u rritur me 4,3 p.p.

Në vitin 2018 pjesa më e madhe e investimeve është realizuar në sektorin e Industrisë nxjerrëse me 22,3 %, ndërsa në vitin 2017 është realizuar në sektorin e Industrisë përpunuese me 36,4 %.

Tab. 7: Struktura e treguesve kryesorë sipas aktiviteteve ekonomik, 2016-2018


Viti	Treguesit	Aktiviteti ekonomik	Industri nxjerrëse	Industri përpunuese	Energji Elektrike dhe Ujë	Ndërtim	Tregti	Akomodim dhe Restorante	Transport Komunikacion	Shërbime të tjera
		NVE Rev.2	05-09	10-32	35-39	41-43	45; 46; 47	55; 56	49-53; 58-63	33; 68-82; 85-96 Përf. 94
2016	Të punësuarit		3,8	38,1	1,9	5,6	9,0	1,8	7,7	32,1
	Shitjet neto		9,2	19,0	7,3	11,6	22,3	0,5	15,3	14,8
	Investimet		3,8	22,1	58,3	2,2	2,9	0,4	5,6	4,8
2017	Të punësuarit		2,5	33,2	1,1	4,8	19,3	1,9	9,7	27,4
	Shitjet neto		5,2	16,2	3,4	7,8	41,3	0,4	10,5	15,2
	Investimet		11,5	36,4	22,2	5,5	7,7	0,5	7,9	8,2
2018	Të punësuarit		2,0	41,7	1,1	4,7	10,2	1,7	8,0	30,6
	Shitjet neto		6,0	17,0	6,7	12,8	24,5	2,0	11,5	19,5
	Investimet		22,3	18,9	21,6	10,0	4,6	0,2	10,3	12,0

Burimi: INSTAT

Përsa i përket strukturës së punësimit për secilin aktivitet ekonomik sipas rajoneve, paraqitur në figurën 6, vërehet se ndërmarrjet me pronësi të huaj dhe të përbashkët kanë pjesën më të madhe të punësimit në sektorin e Industrisë përpunuese me 31,5 % dhe përqindja më e ulët është në sektorin e Akomodimit dhe Restoranteve me 2,5 %.

Vendet e BE-së kanë pjesën më të madhe të punësimit në sektorin e Industrisë përpunuese me 27,9 %. Për vendet e Ballkanit Perëndimor pjesa më e madhe e punësimit është në sektorin e Ndërtimit me 1,7 % dhe për vendet e tjera, sektori i Industrisë nxjerrëse ka pjesën më të madhe të punësimit me 10,9 %.

Fig.6: Struktura e punësimit sipas rajoneve për çdo aktivitet ekonomik, 2018




Burimi: INSTAT

Ndërmarrjet me pronësi të huaj dhe të përbashkët, paraqitur në figurën 7, kanë ndikim më të madh në treguesin e shitjeve neto, krahasuar me punësimin në secilin prej aktiviteteve ekonomike.

Përqindja më e lartë e shitjeve neto të realizuara nga ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta, krahasuar me ndërmarrjet shqiptare është në sektorin e Shërbimeve të tjera me 46,2 %, ku ndikimi më i madh është nga grupi i shteteve të BE-së (39,7 %). Përqindja më e ulët e shitjeve neto për ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta është në sektorin e Tregtisë me 13,9 %.

Shtetet e tjera kanë ndikimin më të madh të shitjeve neto në sektorin e Industrisë nxjerrëse me 39,9 % dhe vendet e Ballkanit perëndimor kanë ndikimin më të madh të shitjeve neto në sektorin e Tregtisë me 3,1 %.


Fig.7: Struktura e shitjeve neto sipas rajoneve për çdo aktivitet ekonomik, 2018



Burimi: INSTAT

Ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta, investimet më të larta i kanë realizuar në sektorin e Industrisë nxjerrëse (71,6 %), sektorin e Transportit, Informacionit dhe Komunikacionit (40,4 %) dhe në sektorin e Industrisë përpunuese (33,9 %). Në sektorin e Industrisë nxjerrëse (67,5 %) ndikimin më të madh e ka grupi i vendeve të tjera, ndërsa në sektorin e Transportit, Informacionit dhe Komunikacionit (29,9 %) dhe në sektorin e Industrisë përpunuese (27,1 %) ndikimin më të madh e ka grupi i vendeve të BE-së.

Fig.8: Struktura e investimeve sipas rajoneve për çdo aktivitet ekonomik, 2018



Burimi: INSTAT

Tabela 8 paraqet strukturën e shitjeve neto të realizuara nga ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta gjatë vitit 2018, sipas vendeve kryesore në çdo aktivitet ekonomik.

Në sektorin e Industrisë nxjerrëse, pjesa më e madhe e shitjeve neto realizohet nga ndërmarrjet e zotëruara nga grupi i vendeve të tjera (92,5 %) ku Republika Popullore e Kinës është vendi dominues me 78,7 %. Për sektorin e Akomodimit dhe restoranteve pjesa më e madhe e shitjeve neto realizohet nga ndërmarrjet e zotëruara nga vendet e BE-së (95,0 %), ku Italia përfaqëson 87,5 %. Në grupin e vendeve të BE-së, Italia dominon gjithashtu dhe në sektorin e Industrisë përpunuese (35,5 %), Energjisë Elektrike, Gazit, Ujit (43,7 %), Ndërtim (44.0 %), Tregti (17,6 %) dhe Shërbimet të tjera (26,0 %). Gjermani dominon në sektorin e Transportit, Informacionit dhe Komunikacionit (28,6 %).

Tab. 8: Struktura e shitjeve për ndërmarrjet me pronësi të huaj dhe të përbashkët sipas shteteve për çdo aktivitet ekonomik, 2018

		%							
Rajonet	Aktivitetet Ekonomike	Industri nxjerrëse	Industri përpunuese	Energji Elektrike & Ujë	Ndërtim	Tregti	Akomodim & Restorante	Transport & Komunikacion	Shërbime të tjera
	NveRev.2	05-09	10-32	35-39	41-43	45; 46; 47	55; 56	49-53; 58-63	33; 68-82; 85-96 excl 94
Shtetet e BE-së	Austria	0,0	0,1	0,0	1,1	0,5	6,6	0,4	3,5
	Britania e madhe	0,0	0,0	0,6	0,4	1,6	0,0	0,0	2,8
	Gjermania	0,3	0,8	11,4	1,0	4,5	0,3	28,6	3,6
	Hollanda	0,0	0,7	0,0	0,0	3,3	0,0	3,1	5,2
	Greqia	1,3	10,3	0,0	20,1	7,3	0,5	24,4	6,6
	Italia	0,9	35,5	43,7	44,0	17,6	87,5	12,5	26,0
	Shtete të tjera të BE-së	4,9	10,1	19,7	1,6	16,8	0,0	1,1	38,3
	Gjithsej Shtetet e BE-së	7,4	57,5	75,4	68,1	51,7	95,0	70,1	85,9
Shtetet e Ballkanit Perëndimor	Bosnja & Hercegovina	0,0	0,0	0,0	0,0	0,1	0,0	0,0	0,0
	Serbia	0,0	3,9	0,0	0,0	0,9	0,0	0,8	0,2
	Kosova	0,1	0,1	0,0	4,0	14,4	0,0	0,7	2,1
	Mali i Zi	0,0	0,0	0,0	0,0	0,2	0,7	0,0	0,0
	Maqedonia e Veriut	0,0	0,4	0,0	0,0	6,8	0,7	0,8	0,2
	Shtetet e Ball. Perëndimor	0,1	4,4	0,0	4,0	22,4	1,4	2,3	2,6
	Emiratet e Bashkuara Arabe	0,7	0,6	10,5	0,8	0,0	0,2	0,1	0,8
Shtete të tjera	Kanada	6,8	0,0	0,0	0,0	0,1	0,0	0,3	0,1
	Republika Popullore e Kinës	78,7	0,0	0,0	0,0	0,9	0,4	10,1	0,0
	Sh B A	3,6	0,1	0,0	2,3	1,4	0,0	0,5	0,3
	Turqi	1,7	28,4	7,9	11,7	6,4	2,8	15,3	2,8
	Zvicër	0,0	0,3	0,0	0,0	8,5	0,0	0,1	2,7
	Shtete të tjera	0,9	8,7	6,2	13,0	8,7	0,2	1,1	4,9
	Shtete të tjera gjithsej	92,5	38,1	24,6	27,9	26,0	3,7	27,6	11,5


Burimi: INSTAT

Cilat janë karakteristikat e ndërmarrjeve me pronësi të huaj dhe të përbashkët?

Gjatë vitit 2018, ndërmarrjet me 50 dhe më shumë të punësuar zënë 27,1 % të të punësuarve gjithsej duke realizuar 25,6 % të shitjeve neto dhe 31,1 % të investimeve gjithsej.

Ndërmarrjet me 5-9 të punësuar kanë ndikimin më të madh në shitjet neto me 38,7 % , me një diferencë shumë të vogël me ndërmarrjet me 1-4 të punësuar që kanë një ndikim në shitjet neto me 38,6 %.

Fig.9: Përqindja e treguesve kryesorë sipas madhësisë së ndërmarrjes, 2018



Burimi: INSTAT

C. Investimet e Huaja Direkte (IHD)

Investimet e Huaja Direkte janë një faktor kryesor i integrimit ekonomik ndërkombëtar dhe globalizimit. Statistikat e besueshme të IHD-ve kanë qenë gjithmonë thelbësore për hartuesit e politikave që përballen me sfidat e tërheqjes dhe shfrytëzimit të investimeve të huaja.

Tab. 9: IHD, Stoku sipas vendeve (mil Euro)

IHD	2016	2017	2018
Stoku gjithsej	5.677,3	6.456,1	7.602,8
EU-28	3.365,8	3.672,2	4.155,3
Austria	359,6	447,5	505,0
Britania e Madhe	38,4	51,2	62,1
Gjermania	122,7	111,5	148,5
Greqia	1.232,6	1.216,8	1.149,0
Italia	604,4	610,1	699,2
Hollanda	718,0	826,8	1.007,2
Të tjera EU	290,1	408,2	584,3
Zvicra	550,1	893,7	1.315,8
Kanada	739,5	883,8	1.000,6
SH B A	80,8	79,1	102,8
Të tjera	941,0	927,3	1.028,3

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në vitin 2018, stoku i IHD është rritur me 17,8 %, krahasuar me vitin 2017. Në fund të vitit 2018, vendet e BE-së përbënin pjesën më të madhe të Stokut (54,7 %), të dominuara nga Greqia me 15,1 % dhe Holanda me 13,2 %.

Tab. 10: IHD, Fluksi sipas vendeve (mil Euro)

IHD	2016	2017	2018
Fluks gjithsej	942,5	899,9	1.019,6
EU-28	241,6	351,2	420,5
Austria	23,1	55,0	56,1
Britania e Madhe	6,5	9,0	7,9
Gjermania	18,7	-20,4	21,2
Greqia	10,3	27,2	- 27,8
Italia	45,7	61,6	52,9
Të tjera EU	137,3	218,8	310,1
Zvicra	432,6	338,6	354,9
Kanada	134,8	149,1	83,4
SH B A	10,2	3,3	13,7
Të tjera	123,4	57,7	147,1

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në vitin 2018 fluksi i IHD është rritur me 13,3 %, krahasuar me vitin 2017. Për vitin 2018, SHBA ka patur rritjen më të madhe me gati 4 herë, ndërsa Gjermania rënien më të madhe me 1 herë, krahasuar me 2017.

Tab.11: IHD, Stoku sipas aktiviteteve (mil Euro)

IHD	2016	2017	2018
Stoku gjithsej	5.677,3	6.456,1	7.602,8
B-Industria nxjerrëse	651,8	865,0	1.071,7
C-Industria përpunuese	607,2	591,1	653,2
(D+E)-Energjia elektrike, gaz, avulli, furnizimi me ujë, etj	1.109,1	1.512,0	2.057,8
J-Informacioni dhe komunikacioni	1.214,6	1.169,5	1.108,3
K- Aktivitete financiare dhe të sigurimit	936,6	1.006,2	1.079,8
Të tjera	1.158,0	1.312,3	1.632,1

Burimi: Banka e Shqipërisë

Sektori i "Energjisë elektrike, gazit dhe furnizimit me ujë" me 27,1 % dhe "Informacionit dhe komunikimit" me 14,6 %, përbënin vlerat më të larta të Stokut në fund të vitit 2018.

Tab. 12: IHD, Fluksi sipas aktiviteteve (mil Euro)

IHD	2016	2017	2018
Fluks gjithsej	942,5	899,9	1.019,6
B-Industria nxjerrëse	157,6	216,2	176,8
C-Industria përpunuese	54,2	22,9	33,9
(D+E)-Energjia elektrike, gazi, avulli, furnizimi me ujë, etj	565,1	407,5	454,0
J-Informacioni dhe komunikacioni	-15,7	-24,1	-66,1
K-Aktivite financiare dhe të sigurimit	72,4	111,8	96,6
Të tjera	108,8	165,6	324,3

Burimi: Banka e Shqipërisë

Sektori i "Energjisë elektrike, gazit dhe ujit" me 44,5 % dhe "Industria nxjerrëse" me 17,3 % përbënin vlerat më të larta të Fluksit të IHD, gjatë vitit 2018.

D. Tregtia e Mallrave sipas Ndërmarrjeve

Ky kapitull ka si qëllim të prodhojë statistika të reja për karakteristikat e shkëmbimit të mallrave në Shqipëri, në periudhën 2016-2018, për ndërmarrjet private me pronësi të huaj dhe të përbashkët.

Në vitin 2018, numri i ndërmarrjeve eksportuese me pronësi italiane është 338 dhe numri i ndërmarrjeve importuese me pronësi italiane është 613. Numri i ndërmarrjeve eksportuese me pronësi greke është 78 dhe numri i ndërmarrjeve importuese me pronësi greke është 156.

Tab. 13 Numri i ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta sipas vendeve, 2016-2018

		Eksportet			Importet		
		2016	2017	2018	2016	2017	2018
Vendet e BE-së	Austria	25	25	13	39	34	16
	Franca	13	14	11	21	23	19
	Gjermania	21	25	20	47	51	55
	Greqia	89	92	78	183	174	156
	Italia	314	353	338	619	652	613
	Hollanda	8	8	9	16	14	14
	Mbretëria e Bashkuar	4	5	4	14	17	19
	Të tjera të BE-së	41	32	37	87	86	85
Vendet e Ballkanit Perëndimor	Bosnja dhe Hercegovina	3	c	c	5	c	c
	Kosova	27	38	34	86	107	97
	Maqedonia e Veriut	7	18	12	25	41	36
	Mali i Zi	c	c	c	c	4	5
	Serbia	7	7	4	13	22	22
Vendet e tjera	Kanada	3	c	c	6	9	5
	Kina	5	7	7	15	31	23
	Zvicra	8	9	11	16	16	19
	Turqia	41	43	29	99	118	96
	Emiratet e Bashkuara Arabe	4	4	12	4	4	13
	SHBA	9	9	7	27	30	25
	Vendet e tjera	38	37	40	76	89	105

Burimi: INSTAT

Në vitin 2018, Italia ka zënë pjesën më të madhe të vlerës së eksporteve (47,1 %), Kina (13,5 %) dhe Turqia (12,5 %). Italia, gjithashtu ka zënë pjesën më të madhe të vlerës së importeve (41,2 %), e ndjekur nga Turqia (12,5 %) dhe Greqia (12,0 %).

Tab.14 Eksportet dhe importet e ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta në totalin e ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta, sipas vendeve, 2016-2018

%

		Eksporti			Importi		
		2016	2017	2018	2016	2017	2018
Vendet e BE-së	Austria	0,9	1,9	0,1	4,2	4,7	0,4
	Franca	1,0	1,3	1,7	7,2	2,7	2,2
	Gjermania	1,9	2,4	2,9	3,9	3,7	6,4
	Greqia	6,5	5,3	5,2	10,9	10,2	12,0
	Italia	54,6	54,2	47,1	36,6	40,6	41,2
	Hollanda	0,0	0,2	1,4	2,0	1,9	2,5
	Mbretëria e Bashkuar	0,0	0,01	0,01	0,1	0,2	0,2
	Të tjera të BE-së	3,7	3,0	4,0	3,8	7,2	5,4
Vendet e Ballkanit Perëndimor	Bosnja dhe Hercegovina	0,0	c	c	0,2	c	c
	Kosova	1,0	1,4	4,2	1,1	1,5	2,8
	Maqedonia e Veriut	0,2	0,2	0,02	0,8	0,9	1,6
	Mali i Zi	c	c	c	c	0,03	0,04
	Serbia	0,7	0,4	0,01	2,3	3,4	1,5
Vendet e tjera	Kanada	16,4	c	c	2,1	2,6	0,01
	Kina	0,2	0,2	13,5	0,3	0,8	3,2
	Liban	3,4	2,5	2,3	0,7	0,9	c
	Zvicra	0,9	0,01	0,1	11,2	4,7	3,1
	Turqia	5,9	9,3	12,5	9,4	10,2	12,5
	Emiratet e Bashkuara Arabe	1,3	1,6	2,5	1,2	1,7	0,9
	SHBA	0,3	0,2	0,1	0,5	0,7	1,0
	Vendet e tjera	1,0	5,2	2,2	1,4	1,2	2,1

Burimi: INSTAT

Për vitin 2018, eksportet e ndërmarrjet të huaja dhe të përbashkëta përbënin 50,9 %, të eksporteve, nga 49,2 % në vitin 2017. Ndërsa, importet e këtyre ndërmarrjeve përbënin 27,5 %, të importeve, nga 28,8 % në vitin 2017.

Tab. 15 Struktura eksport / import e ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta në totalin e ndërmarrjeve, 2016-2018

%

Madhësia e ndërmarrjeve	Aktiviteti (NVE Rev.2)											
	2016				2017				2018			
	Totali	B-E Industri	G Tregti	Të tjera	Totali	B-E Industri	G Tregti	Të tjera	Totali	B-E Industri	G Tregti	Të tjera
Eksportet												
Totali	48,2	51,1	28,8	57,4	49,2	50,6	42,6	43,6	50,9	52,5	35,8	68,4
1-9	47,7	58,3	44,1	21,3	48,5	55,5	46,2	37,7	53,2	66,3	46,0	38,0
10-49	25,7	27,0	16,8	51,0	30,0	29,7	24,5	50,1	37,0	26,8	42,3	79,1
50-249	47,5	48,1	11,2	86,6	49,5	51,5	c	c	39,8	41,8	c	c
250+	58,2	59,3	-	84,3	57,7	55,9	c	c	65,8	66,3	c	c
Importet												
Totali	29,0	49,3	13,2	46,9	28,8	49,2	14,8	31,8	27,5	47,5	13,0	39,0
1-9	29,2	52,4	16,5	58,9	24,1	60,9	16,3	18,6	17,3	37,4	13,2	20,0
10-49	22,0	45,4	12,9	28,6	24,0	43,0	16,1	39,1	20,9	51,2	11,9	32,0
50-249	28,8	48,3	c	c	29,2	47,6	c	c	24,7	34,1	c	c
250+	43,1	52,5	c	c	40,5	51,5	c	c	48,8	61,0	c	c

Burimi: INSTAT

Për vitin 2018, eksportet e ndërmarrjeve nga BE përbënin 62,4 %, të eksporteve të ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta, nga 68,3 % në vitin 2017. Ndërsa, importet e këtyre ndërmarrjeve përbënin 67,0 %, të importeve, nga 71,3 % në vitin 2017.

Tab. 16 Struktura eksport / import e ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta nga BE në totalin e ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta, 2016-2018

%

Madhësia e ndërmarrjeve	Aktiviteti (NVE Rev.2)											
	2016				2017				2018			
	Totali	B-E Industri	G Tregti	Të tjera	Totali	B-E Industri	G Tregti	Të tjera	Totali	B-E Industri	G Tregti	Të tjera
Eksportet												
Totali	68,7	70,2	63,8	44,3	68,3	72,8	40,7	59,3	62,4	62,9	53,0	70,8
1-9	68,8	73,7	63,9	76,7	66,2	87,4	55,6	63,1	90,1	95,0	86,8	73,4
10-49	80,6	88,3	65,1	61,5	74,3	88,0	57,9	40,6	50,2	64,1	23,4	70,2
50-249	87,6	91,4	56,0	33,5	91,3	91,3	c	c	76,8	77,5	c	c
250+	53,1	53,4	-	24,9	49,7	54,0	c	c	54,3	53,7	c	c
Importet												
Totali	68,7	68,2	70,0	68,6	71,3	72,0	69,6	71,4	67,0	63,6	64,6	86,3
1-9	78,3	53,9	77,7	95,6	79,3	87,5	72,4	76,6	72,4	81,5	68,0	71,3
10-49	39,5	22,2	58,9	52,3	54,9	41,0	63,0	65,8	60,0	57,4	57,2	78,0
50-249	87,0	94,4	77,0	49,7	87,9	92,2	c	c	75,9	77,7	c	c
250+	68,9	76,0	-	46,1	62,6	61,8	c	c	62,4	56,1	c	c

Burimi: INSTAT